

---



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”**  
**ZYRA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. Prot....

Gjirokastër, më 29.12.2020

**Relacion mbi veprimtarinë e Zyrës së Marrëdhënieve me publikun 2019 - 2020**

Misioni themelor i Zyrës së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun është të realizojë në kohë dhe transparencë informimin e publikut të gjërë mbi veprimtarinë dhe aktivitetin e institucionit nëpërmjet prodhimeve mediatike dhe internetit, në funksion të përmirësimit të imazhit të Universitetit “Eqrem Çabej” si dhe të realizoj një komunikim transparent e të qartë për publikun.

Ky sektor e organizon punën në përputhje me ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ligji nr.9887, datë 13.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe ligji nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në adminisstratën publike”.

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun në UGJ organizon takimet e rektorit apo zv/rektorit me mediat.

- Organizon dhe menaxhon faqen zyrtare të Universitetit në Facebook dhe Instagram duke e përditësuar me informacionin e nevojshëm.
- Organizon dhe dokumenton aktivitetet nëpërmjet fotografive dhe videoove.

Kjo zyrë përbëhet nga një specialiste për Marrëdhëni me Publikun.

Marrëdhëni me Publikun janë një mënyrë e përcjelljes së mesazhit tek publiku, me qëllim ndikimin mbi opinionin e tij, përmes një tërësie mjetesh komunikimi. Eventet publike, emisionet radiotelevizive, kontaktet e herëpashershme me shtypin janë mënyra më e mirë për t'u lidhur me publikun/kategoritë të komunitetit.

Duke ndjekur këto parime zyra e Marrëdhënieve me Publikun në UGJ ka organizuar intervista të vazhdueshme të drejtuesve të institucionit me median lokale për informimin e saj për securinë e institucionit.

Në vitin 2019 Zyra organizoi ceremoninë e diplomimit pas një periudhe ndërpërrejeje në universitet me synimin për ta kthyer në traditë. Pandemia ndikoi në morealizimin e saj për vitin 2020.



Në bashkëpunim me Zyrën e Punës u bë e mundur punësimi i disa studentëve që përfituan nga Programet e Punësimit duke kryer praktikën profesionale në disa institucione dhe biznese, në disa prej të cilave u punësuan me kohë të plotë në përfundim të kësaj praktike.

Në fokus të zyrës ka qenë informimi i përditshëm nëpërmjet rrjeteve sociale, krahas aktivitetave të ndryshme apo takimeve që janë organizuar në ambientet e universitetit.

Me qëllim promovimin e universitetit dhe thithjen e studentëve të rinj, zyra organizoi një fushatë promovimi në mediat lokale dhe ato të rajonit të jugut duke shpërndarë reklama në televizionet e Vlorës, Fierit, Sarandës, Gjirokastrës.

Në rrjetet tona sociale ruajmë komunikim të rregullt dhe të vazhdueshëm me studentët duke iu përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe kërkesave të tyre. Zyra informon në mënyrë të rregullt mbi të gjitha risitë, aplikimet, formularët, njoftime të ndryshme të cilat janë në shërbim të studentëve.

Edhe gjatë periudhës së karantinimit si pasojë e pandemisë, zyra ka vijuar punën normalisht duke publikuar njoftime, publikime motivuese, informacione mbi mësimin online etj.

Zgjedhjet 2020 në IAL u pasqyruan në mënyrë të drejtë dhe korrekte në mediat lokale nëpërmjet komunitetit të vazhdueshëm medatik me Zyrën e Marrëdhënive me Publikun që ka si pikën kryesore të punës së saj komunikimin me median dhe përfaqësimin e universitetit në të gjitha takimet mediatike.

Aktualisht Zyra vazhdon punën duke qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me studentët nëpërmjet rrjeteve sociale dhe faqeve tona zyrtare në FB dhe Instagram.

### Specialiste e Zyrës së Marrëdhënive me Publikun

Brikena Metaj

